



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenas
Kuvendi i Komunës**



Nr. 12-400/01-4108 dt. 26.01.2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40, të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës “),nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit , Shkresës Nr.020-982/7 të dates 31.12.2021, të MAPL-së, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë **26. 01.2022**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 12-400/01-65504 të dates 23.12.2021

Neni 1

Më këtë Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit Nr.12-400/01-65504, të dates 23.12.2021, për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Palujtshme për vitin 2022.

Neni 2

Me shfuqizimin e vendimit Nr..12-400/01-65504 , të datës 23.12.2021 , mbeten në fuqi normat tatimore për Tatimin në Pronën e Palujtshme , siç kanë qenë të parapara për vitin 2021 , ashtu siç parashihet në Legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nga nënshkrimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

ARSYETIM

Kuvendi I Komunës së Drenasit me datë 23.12.2021 ka aprovuar vendimin nr.12-400/01-65504 për caktimin e normave tatimore për Tatimin në pronën e Palujtshme për vitin 2022., mirëpo pas vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal sipas shkresës Nr.020-982/7,të datës 31.12.2021 është kërkuar nga ana e Komunës së Drenasit se për vitin 2022 për komunën e Drenasit të vlejné normat tatimore të vendosura për vitin 2021, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 9 të ligjit nr.06/L-005, për tatimin në pronën e Palujtshme.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Elm Hajdari

REPUBLIKA E KOSOVËS / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Qeveria e Kosovës / Ministarstvo za Finansije
Ministria e Financave / Ministry of Finance
Arkiva - Archive

Nr. Org. 02/2021/150
Org. Jedin. 2310-3/2021
Org. Unit

Nr. i faqeve 7
Br. i shprehjeve 10.02.2022
No. pages: 10.02.2022

Dalës PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetari i Komunës së Drenasit Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha , Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Hekuran Murati , Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 07.02.2022
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 004/2022	
I. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora , Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari.

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-400/01-65504 të datës 23.12.2021</i>
<i>I miratuar më datë 26.01.2022</i>
<i>I parashituar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 27.01.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 01.02.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Drenasit, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Më datë 28 Dhjetor 2021, Ministria ka pranuar për shqyrtim të ligjshmërisë një akt administrativ nga Komuna e Drenasit, me anë të së cilit është synuar caktimi i normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike.
2. Për ilustrim të mëtejme të situatës faktike, më datë 30 Dhjetor 2021, Ministria ka konstatuar se Komuna nuk ka vepruar në konformitet me konditat ligjore procedurale të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, duke u mbështetur në vlerësimin se vendimi komunal nuk ishte lëshuar brenda afatit ligjor.
3. Rrjedhimisht, Ministria ka konstatuar për Komunën e Drenasit se për periudhën tatimore 2022 të Komunës do të vlejnjë normat tatimore të vendosura për vitin 2021, dhe ka kërkuar nga organizata buxhetore ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e aktit dhe harmonizimin e të njëjtit me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Ndërlidhur me këtë kërkesë të Ministrisë, Komuna e Drenasit me anë të vendimit që është subjekt i këtij vlerësimi ka shfuqizuar aktin komunal të cilin Ministria e pati konstatuar të kundërligjshëm.
5. Me anë të këtij shfuqizimi, Komuna e Drenasit ka vepruar në përputhje me nenin 9, paragrafin 4 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, duke respektuar kështu, përmes shfuqizimit, edhe procesin ligjor të mbikëqyrjes së akteve komunale.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë shkresë.

Me respekt!